

VENDIM
Nr. 233, datë 27.3.2013

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 25.9.2012 PËR ÇËSHTJEN NR. 58555/10 “RRAPO KUNDËR SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 25.9.2012 për çështjen nr. 58555/10 “Rrapo kundër Shqipërisë”, në shumën 1 500 (një mijë e pesëqind) euro, si dhe çdo taksë që mund të jetë e ngarkueshme për dëmin moral.

2. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Shuma e përcaktuar si detyrim në pikën 1 të këtij vendimi, të depozitohet në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesit, z. Almir Rrapo, dhe të konvertohet në lekë me kursin e këmbimit të bankës, ku është depozituar shuma në datën e kryerjes së pagesës.

4. Pagimi i shumës së depozituar sipas pikës 4 të këtij vendimi, në favor të ankuesit, z. Almir Rrapo, të bëhet nga Ministria e Financave pas paraqitjes së të gjithë dokumentacionit ligjor të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga Buxheti i Shtetit. Afati përfundimtar i pagesës sipas vendimit të Gjykatës Europiane është data 25.3.2013.

Në rast mospagimi brenda këtij afati, mbi shumën e mësipërme paguhen interesa të thjeshta të barabarta me kursin marzhinal të huas së Bankës Qendrore Europiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus tre për qind, sipas parashikimit në pikën 4 shkronja “c” të vendimit të Gjykatës.

5. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha